



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2193

Data: 12/10/2020

Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 07. 10. 2020 mori këtë:

VENDIM

Për vazhdim të përkohshëm të kontratave të rregullta të punës për personelin akademik të cilëve iu kanë skaduar kontratat në mungesë të konkursit për riemërim apo avancim atyre që iu skadon gjatë vitit akademik 2020/21, si dhe për ligjëruesit e UP-së


- I. Lejohet vazhdimi i përkohshëm i kontratave për kategorinë e personelit akademik të cilët kanë pasur kontratë të rregullt e punës me kohëzgjatje deri me datë 30.09.2020. Kjo kategori e personelit akademik do t'i nënshtrohet procedurave të konkursit i cili do të publikohet në muajt në vijim. Vazhdimi i kontratave të përkohshme bëhet deri në përfundim të procedurave të konkursit, por jo më gjatë se deri me datë 30.9.2021.
- II. Lejohet vazhdimi i përkohshëm i kontratave për kategorinë e personelit akademik të cilëve kontrata e rregullt e punës u skadon brenda vitit akademik 2020/21. Kontratat vazhdojnë nga momenti i skadimit të kontratës së fundit deri me datë 30.09.2021, respektivisht deri në përfundim të procedurave të konkursit në radhë.
- III. Personelit me thirrje akademike Ligjërues, iu vazhdojnë kontratat prej 1.10.2020 deri më 30.9.2021.

Arsyetim

1. Vazhdimi i kontratave për kategorinë e personelit akademik të specifikuar në pikë I, II dhe III të këtij vendimi bëhet në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor në Universitetin e Prishtinës dhe në mënyrë që asnjë anëtarë i personelit akademik të mos të mbetet pa kontratë të rregullt të punës gjatë periudhës së sipërshënuar. Universiteti i Prishtinës nuk ka mundësi që brenda një konkursi për emërimin, riemërimin apo avancimin e personelit akademik të përfshijë të gjithë personelin akademik të cilëve në vazhdimësi u skadojnë kontratat brenda vitit akademik, prandaj mbi këtë bazë Senati i UP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi .

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Dekanëve dhe sekretarëve të Fakulteteve,
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së,
4. Zyrës për çështje akademike, dhe
5. Zyrtarit ligjor të UP-së.



Kryesues i Senatit

Prof. Dr. Naseri Sahiti, rektor